



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opstina Gnjilane
Municipality Gjiçan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA PËR RINI, KULTURË DHE SPORTE

- Bordi Drejtues
- Stafi Organizativ i Manifestimit Kulturor “Flaka e Janarit 2012”, shpall:

KONKURS

a) – Arti Letrar:

PENA E FLAKES 2012 KONKURSI LETRAR.

- Për Tregim të shkurtër (çmimi i parë – 250 €; çmimi i dytë – 200 €, dhe çmimi i tretë – 150 €)
- Për poezi: (Çmimi i parë – 250 €, Çmimi i dytë – 200, dhe Çmimi i tretë – 150 €).

Në Konkurs, me një apo më tepër punime (për tregim – deri tri faqe klasike, e për poezi – deri më 50 vargje) të pabotuara (as në faqe të internetit). të nënshkruara me shifër, të dërgohen përmes PTK-ës, apo në mënyrë tjetër, të drejtohen në adresën: Drejtoria Për Kulturë, Rini e Sporte (në objektin e Teatrit të Qytetit), me parashenjen “për Konkurs të “Flakës” ose në adresën elektronike dkrs_gj@yahoo.com.

Konkursi, me temë të lirë, është i hapur (për të gjithë krijuesit e trojeve tona etnike) deri më 10 janar, ndërkaj që Juria vlerësuese, rezultatet do t'i shpall në “Orën e Madhe Letrare”, më 25 janar, ndërsa punimet e shpërblyera dhe ato më të dalluarat, do të botohen në Revistën “Agmia”. Krijimet që nuk i përmbahen kritereve të sipër përmendura nuk do të meren parasysh.

b) – Arti Pamor:

PENELI I FLAKES 2012 EKSPOZITE MBAREKOMBETARE.

Për punime të sferës së Artit pamor, për Ekspozitën kolektive mbarekombetare që do të hapet në Galerinë e Qytetit.

Te gjithë artistet profesional mund të konkurojnë me një(1) veper permasat e se ciles duhet te jene jo me te medha se 120cm dhe te jete e pa ekspozuar me pare dhe teknikisht te pergatitur.

(Çmimi blerës për Fondin e Galerisë – 500 €, dhe tri çmime të tjera në vlerë prej 150 €).

Punimet, jo me të “vjetra” se dy vite, teknikisht të përgatitura, dhe të paeksponuara më parë, me tematikë të lirë, të dorëzohen në Galerinë e Qytetit, gjatë orarit, në ditët e punës, deri më 31 dhjetor 2011 .

Në Konkurs, mund të marrin pjesë krijuesit e të gjitha trojeve tona etnike, ndërkaq që punimet e përzgjedhura, do të ekspozohen në Ekspozitën e “Flakës...” me 17 Janar e me pas do të katalogohen sic është bërë traditë tashmë.

c) Për Festivalin e dramës kombërate “Talia e flakës”, Juria seleksionuese do të përzgjedhë gjashtë(6) shfaqje që do të jenë konkurrese për çmimet që ofron ky festival.

d)-arti muzikor:

FEST FLAKA

“Festival mbarëkombëtar i këngës popullore në frymën e traditës”

Karakteri i festivalit është garues. Juria profesionale do të përzgjedh 10 (dhjetë) interpretues të këngës popullore në frymën e traditës, me motive të ndryshme, nga treva të ndryshme të shqiptarisë, duke mos i anashkaluar as solistët vendor, të cilët do të garojnë për këto shpërblime:

- Çmimi i Parë – 500 euro,
- Çmimi i Dytë – 300 euro dhe
- Çmimi i Tretë – 200 euro.

Afati i aplikimit është nga 10 deri më 30 dhjetor 2011.

Bordi Drejtues i “Flakës së Janarit 2012”